VENDIM
Nr. 762, datë 12.12.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 8/3, fjalët "... dhe në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike...." hiqen.

b) Në pikën 9/4, pas fjalëve "... kategoritë e pagave ..." shtohen "... dhe shtesat për kushte pune ...".

c) Në lidhjen nr. 5, pas fjalëve "... menaxher trajnimi në Shkollën Shqiptare të Administratës publike (ASPA) ..." shtohen "... specialist në drejtoritë dhe sektorët e përmbajtjes në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike ...".

ç) Në titullin e lidhjes nr. 5/3, fjalët "... dhe në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike ..." hiqen.

d) Lidhja nr. 6/4 zëvendësohet me lidhjen, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

dh) Në lidhjen nr. 6/7, vlerat e kolonës "Shtesa e pozicionit" për:

i. klasifikimin doganor C3 bëhet 42 800 (lekë);

ii. klasifikimin doganor D1 bëhet 39 600 (lekë).

e) Në lidhjen nr. 9:

i. Përpara rreshtit

Titullar i agjencive rajonale të mjedisit	III-a/1	1

shtohet rreshti, me këtë përmbajtje:

Drejtor i drejtorive rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive	III-a	1

ii. Pas emërtesës "Përgjegjës i degëve të thesarit në qendër qarku" shtohet emërtesa "Përgjegjës sektori në drejtoritë rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.".

iii. Pas emërtesës "Titullar i institucionit vendor" shtohet emërtesa "Përgjegjës i zyrës vendore të punësimit në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.".

iv. Pas emërtesës "Specialist në zyrën vendore të Shërbimit të Provës" shtohet emërtesa "Specialist në njësitë teknike të përmbajtjes në drejtoritë rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.".

v. Emërtesa "Specialist në zyrat vendore të punësimit" zëvendësohet me emërtesën "Specialist në zyrat vendore të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.".

2. Efektet financiare për përcaktimet:

a) për Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike fillojnë nga data 1 nëntor 2022;

b) në lidhjen nr. 6/4 fillojnë nga data 1 janar 2023 dhe përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë;

c) në lidhjen nr. 6/7 fillojnë nga data 1 shtator 2022 dhe për vitin 2022 përballohen nga fondet e lira si pasojë e vakancave në strukturat e institucionit, si dhe nga fondet e miratuara me aktin normativ nr. 12, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, në kuadër të paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës;

ç) në lidhjen nr. 9 fillojnë nga momenti i transferimit/emërimit të nëpunësve në pozicionet e reja sipas strukturës dhe organikës së re të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe për vitin 2022 përballohen nga buxheti i miratuar për sistemin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 6/4

KATEGORITË E PAGAVE DHE SHTESAT PËR KUSHTE PUNE TË POZICIONEVE TË PUNËS SË NËPUNËSVE PËR EMËRTESAT "SPECIALIST" DERI NË "TITULLAR INSTITUCIONI" NË INSTITUTIN E SIGURISË USHQIMORE DHE VETERINARISË

POZICIONI	**KATEGORIA**	**KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT**	**SHTESA PËR KUSHTE PUNE**
Titullar i institucionit.	II-a	1	15 000
Zëvendëstitullar i institucionit përgjegjës departamenti/drejtor në drejtoritë e përmbajtjes	II-b	1	15 000
Drejtor në drejtoritë mbështetëse	III-a	1	0
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes	III-a	1	15.000
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës	III-a/1	1	0
Specialist me grada e tituj shkencorë, në departamentet/drejtoritë dhe sektorët e përmbajtjes	III-b	1	20 000
Specialist të kërkimit teknologjik në departamentet/drejtoritë dhe sektorët e përmbajtjes	III-b	1 ose 2	10 000

Specialist në sektorët dhe drejtoritë mbështetëse	IV-a IV-b	1 ose 2, ose 3	0